<p>Article 13 - General Assembly Meetings</p> <p>13.1 Convening General Assembly Meetings</p> <p>The Administrator may convene a General Assembly meeting at any time. In any case, the General Assembly meeting shall be called at least once a year, no later than June of each year in order to discuss, review and approve the Company's annual financial statements. The Shareholders shall hold the General Assembly meeting at such place as the person/body convoking the meeting determines but reserving the possibility for each Shareholder to participate via electronic means in accordance with article 13.5 below.</p> <p>13.2 Notice of General Assembly Meetings</p> <p>Written notice of a General Assembly meeting shall be given to each Shareholder at least 7 calendar days in advance, by registered post or email with delivery receipt, unless the Shareholders approve in writing a shorter notice period. Such notice shall be accompanied by an agenda identifying in reasonable detail the matters to be discussed at the meeting together with copies of any relevant papers to be discussed at the meeting and proposed resolutions.</p> <p>13.3 Quorum and Voting at General Assembly Meetings</p>	<p>Neni 13 – Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme</p> <p>13.1 Thirrja e Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme</p> <p>Administratori mund të thërrasë një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme në çdo kohë. Në çdo rast, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se qershori i çdo viti, për të diskutuar, shqyrtuar dhe miratuar pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë. Ortakët do të mbajnë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në një vend të përcaktuar nga personi/organi i cili thërret mbledhjen, por duke i dhënë mundësinë secilit Ortak të marrë pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike sipas nenit 13.5 më poshtë.</p> <p>13.2 Njoftimi për Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme</p> <p>Njoftimi me shkrim për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme do t'i jepet çdo Ortaku të paktën 7 ditë kalendarike paraprakisht, me postë të regjistruar ose me email me faturë dorëzimi, përveç nëse Ortakët miratojnë me shkrim një afat më të shkurtër njoftimi. Ky njoftim do të shoqërohet me një rend dite i cili identifikon në detaje të arsyeshme çështjet që do të diskutohen në mbledhje së bashku me kopjet e çdo dokumenti përkatës dhe vendimet e propozuara të cilat do të diskutohen në mbledhje.</p> <p>13.3 Kuorumi në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme</p>
---	---

The quorum for transacting business at any General Assembly Meeting (including a General Assembly Adjourned Meeting) shall be more than 30% of the Shares of the Company for resolutions requiring simple majority and more than 50% of the Shares for resolutions requiring qualified majority pursuant to the Company Law. If a quorum is not present within 60 minutes from the time when the meeting should have begun or if during the meeting there is no longer a quorum, the meeting shall be adjourned to and reconvened to the same time and place on the Business Day falling five (5) Business Days immediately after the proposed date of the meeting, unless all Shareholders agree in writing another period (the "General Assembly Adjourned Meeting"). Notice of the General Assembly Adjourned Meeting shall be given to all absent Shareholders.

13.4 Voting at General Assembly Meetings

- a. The Chairman of the meeting shall be nominated by the present Shareholders with simple majority. The secretary of the meeting shall be appointed by the Chairman and may be a notary public.
- b. Subject to article 13.3, a resolution of the Shareholders is passed by a simple majority vote with the exception of decisions requiring qualified majority

Kuorumi për transaksionet e biznesit në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme (përfshirë një Mbledhje të Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme) do të jetë të më shumë se 30% e Kuotave të Shoqërisë, për vendime për të cilat kërkohet shumicë e thjeshtë dhe më shumë se 50% e Kuotave të Shoqërisë për vendime për të cilat kërkohet shumicë e cilësuar, sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Nëse kuorumi nuk është i pranishëm brenda 60 minutash nga koha kur mbledhja duhet të kishte filluar ose nëse gjatë mbledhjes nuk ka më kuorum, mbledhja do të shtyhet dhe do të mbledhet në të njëjtën kohë dhe vend gjatë Ditës së Punës e cila është pesë (5) Ditë Pune menjëherë pas datës së propozuar të mbledhjes, përveç nëse të gjithë Ortakët bien dakord me shkrim për një periudhë tjetër ("Mbledhja e Shtyrë e Asamblesë së Përgjithshme"). Njoftimi për Mbledhjen e Shtyrë të Asamblesë së Përgjithshme do t'u jepet të gjithë Ortakëve që mungojnë.

13.4 Votimi në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- a. Kryetari i mbledhjes do të emërohet nga ortakut e pranishëm me shumicë të thjeshtë. Sekretari i mbledhjes do të emërohet nga Kryetari dhe mund të jetë noter.
- b. Sipas nenit 13.3, vendimi i ortakëve merret me shumicë të thjeshtë votash, me përjashtim të vendimeve që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare (75% të votave të Ortakëve

under the Company Law (75% of the votes of the Shareholders present in the meeting) i.e. modification of the Articles of Association, distribution of profits, increase or decrease of the Company's registered capital, restructuring and dissolution of the Company. A simple majority or qualified majority, as applicable, shall be determined in accordance with the voting rights attached to the Shares of the Shareholders participating at the meeting; provided, however, that abstaining votes shall not be counted.

- c. The minutes of the General Assembly Meeting shall be signed by the Chairman and the secretary of the meeting. Extracts of the resolutions passed at the General Assembly Meeting required for filings under the Company Law shall be prepared by the Chairman and, if necessary, shall be signed by all Shareholders present and voting at the meeting. If any of the Shareholders refuses to sign within ten (10) days from receipt the extract, the extract shall be considered as a true extract of the resolutions passed at the meeting by the sole signature of the Chairman and countersignature of the secretary of the meeting.

13.5 Participation in General Assembly Meetings

A Shareholder may participate in a General Assembly meeting by means of telephone, videoconference or similar form of

të pranishëm në mbledhje) pra, ndryshimi i Statutit, shpërndarja e fitimeve, rritja ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ristrukturimi dhe prishja e Shoqërisë. Një shumicë e thjeshtë ose e cilësuar, sipas rastit, do të përcaktohet në përputhje me të drejtat e votës që i bashkëlidhen Kuotave të Ortakëve që marrin pjesë në mbledhje, megjithatë, me kusht që votat abstenuese të mos numërohen.

- c. Procesverbali i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nënshkruhet nga Kryetari dhe sekretari i mbledhjes. Ekstraktet e vendimeve të miratuara në Mbledhjen e Përgjithshme të kërkuara për depozitim sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare përgatiten nga Kryetari dhe, nëse është e nevojshme, nënshkruhen nga të gjithë Ortakët e pranishëm dhe që votojnë në mbledhje. Nëse ndonjë nga Ortakët refuzon të nënshkruajë brenda dhjetë (10) ditëve nga marrja e ekstraktit, ekstrakti do të konsiderohet si ekstrakt i vërtetë i vendimeve të marra në mbledhje me nënshkrimin e vetëm të Kryetarit dhe kundër-firmën e sekretarit të mbledhjes.

13.5 Pjesëmarrja në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Një Ortak mund të marrë pjesë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme me anë të telefonit, video konferencës

<p>communications equipment which allows all Shareholders participating in the meeting to hear and speak to each other throughout the meeting. A person participating in this way is deemed to be present in person at the meeting and is counted in the quorum and entitled to vote.</p>	<p>ose formave të ngjashme të pajisjeve të komunikimit të cilat u mundësojnë të gjithë Ortakëve në mbledhje të dëgjojnë dhe flasin me njëri-tjetrin gjatë gjithë mbledhjes. Një person i cili merr pjesë në këtë mënyrë konsiderohet të jetë i pranishëm personalisht në mbledhje dhe do të numërohet në kuorum dhe ka të drejtë vote.</p>
<p>13.6 Location of General Assembly Meetings</p> <p>If all the Shareholders participating in a meeting are not in the same place, then the meeting is to be treated as taking place at the registered office of the Company.</p>	<p>13.6 Vendndodhja e Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme</p> <p>Nëse të gjithë Ortakët që marrin pjesë në një mbledhje nuk janë në të njëjtin vend, atëherë mbledhja do të trajtohet si e zhvilluar në selinë e Shoqërisë.</p>
<p>13.7 Written resolution of Shareholders</p> <p>The General Assembly may resolve by written resolution without convening a General Assembly meeting, provided that all Shareholders vote in favour of such resolution. Notice of a proposed General Assembly written resolution must be given in writing to each Shareholder. Notwithstanding any other provision of these Articles of Association, a General Assembly written resolution is adopted when each of the Shareholders has voted in favour of such resolution and signed one or more copies of it. Once a General Assembly written resolution has been adopted, it shall be treated as if it had been a decision taken at a General Assembly meeting in accordance with the Articles of Association and the Company Law.</p>	<p>13.7 Vendimi me shkrim i Ortakëve</p> <p>Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë me anë të një vendimi me shkrim pa thirrur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, me kusht që të gjithë Ortakët të votojnë në favor të këtij vendimi. Njoftimi i një vendimi me shkrim të propozuar nga Asambleja e Përgjithshme duhet t'i jepet me shkrim çdo Ortaku. Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e këtij Statuti, një vendim me shkrim i Asamblesë së Përgjithshme miratohet kur secili prej Ortakëve ka votuar në favor të këtij vendimi dhe ka nënshkruar një ose më shumë kopje të saj. Pasi të jetë miratuar një vendim me shkrim i Asamblesë së Përgjithshme, ai do të trajtohet sikur të ishte një vendim i marrë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.</p>

Article 14 – The Administrator	Neni 14 – Administratori
<p>14.1 The Company will have one or more Administrators, who shall have the power to manage individually and without limitation the day-to-day activities of the Company.</p>	<p>14.1 Shoqëria do të ketë një ose më shumë Administratorë, të cilët do të kenë kompetencën për të menaxhuar individualisht dhe pa kufizime aktivitetet e përditshme të Shoqërisë.</p>
<p>14.2 The Administrators, if more than one is appointed, shall act individually and represent the Company without limitation before third parties. Any Administrator may delegate through a power of attorney any of its powers to the other Administrator(s) or to any third party.</p>	<p>14.2 Administratorët, nëse emërohen më shumë se një, do të veprojnë individualisht dhe do ta përfaqësojnë shoqërinë pa kufizim para palëve të treta. Çdo administrator mund t'i delegojë me autorizim ndonjë nga kompetencat e tij administratorit(ëve) tjetër ose ndonjë pale të tretë.</p>
<p>14.3 The Administrator is obliged to keep confidential the information of the Company they have obtained during the exercise of their duties and perform their duties in compliance with the Company Law. When an Administrator as result of its acts or omissions to act, in breach of the Company Law or these Articles of Association causes a material or moral damage to the Company, he is liable for the damage caused.</p>	<p>14.3 Administratori është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit të Shoqërisë që ka marrë gjatë ushtrimit të detyrave të tij dhe të kryejë detyrat e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Kur një Administrator si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tij, në kundërshtim me ligjin për shoqëritë tregtare ose këtë Statut i shkakton Shoqërisë një dëm material ose moral, ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar.</p>
<p>14.4 The managing and representation powers of any Administrator, and any limitation thereof, can be determined and/or amended by resolution of the General Assembly of the Company adopted from time to time, such amendment not to be construed as an amendment of these Articles of Association.</p>	<p>14.4 Kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të çdo administratori, dhe çdo kufizim i tyre, mund të përcaktohen dhe/ose të ndryshohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, të miratuar herë pas here, një ndryshim i tillë nuk do të konsiderohet si një ndryshim i Statutit të Shoqërisë.</p>

<p>14.5 The Administrator is appointed for a period or a term not exceeding 5 (five) years as indicated in the resolution for their appointment and its removal is decided by resolution of the General Assembly adopted with simple majority.</p> <p>14.6 Any time a reference is made to the Administrator in these Articles of Association, it should be construed as a reference to any of the Administrators of the Company if more than one has been appointed.</p>	<p>14.5 Administratori emërohet për një periudhë ose një mandat jo më shumë se 5 (pesë) vjet, siç përcaktohet në vendimin për emërimin e tyre dhe shkarkimi do të vendoset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të miratuar me shumicë të thjeshtë.</p> <p>14.6 Në çdo rast kur ky Statut i referohet Administratorit, kjo do të konsiderohet si referencë për cilindo nga Administratorët e Shoqërisë nëse është emëruar më shumë se një.</p>
<p align="center">Article 15 – Fiduciary Duties and Liability</p>	<p align="center">Neni 15 – Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia</p>
<p>15.1 In addition to general fiduciary duties laid down in Article 13, 14, 15, 17 and 18 of the Company Law, the Administrator(s) must:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. perform their duties under the Company Law, these Articles of Association or set out by resolutions of the General Assembly in good faith and in the best interest of the Company as whole, paying particular attention to the impact of its operation on the environment; b. exercise their powers granted to them by the Company Law, these Articles of Association or set out by resolutions of the General Assembly, only for the purposes established therein; c. give adequate consideration to the matters to be decided; 	<p>15.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori (ët) duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, këtë Statut apo vendimet e Asamblesë së përgjithshme në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis; b. ushtrojnë kompetencat që u njihen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, ky Statut ose vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këto dispozita; c. vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

<p>d. prevent and avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the Company;</p> <p>e. exercise due diligence and care of a reliable and conscientious businessperson and shall observe secrecy with regard to confidential matters;</p> <p>f. provide any information regarding business and economic data requested by any Shareholder within reasonable time and in any case not later than 7 (seven) days. Information and data must be up to date.</p> <p>15.2 The Administrator(s) shall, in the performance of their duties, be held liable to the Company for an act or omission which is rationally related to the object of the Company, unless, pursuant to an inquiry and evaluation of the relevant information, the act or omission was in good faith.</p> <p>15.3 In case of violation of duties and standards of due diligence referred to in paragraphs 1 and 2 of the present Article 15, the Administrator shall have a duty to compensate the Company for any damages resulting from the violation. He/she shall also disgorge any personal gains obtained by him or related persons during the violation of his duties. He/she shall have the burden of proving the compliance with his duties and the required standards. Where a violation has been committed by more than one person, all persons in question shall be jointly and severally liable to the Company.</p>	<p>d. parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;</p> <p>e. ushtrojnë kujdesin e duhur të një biznesmeni dhe ruajë fshehtësinë për çështjet konfidenciale;</p> <p>f. sigurojnë çdo informacion në lidhje me të dhënat e biznesit dhe ekonomike të kërkuara nga çdo Ortak brenda një kohe të arsyeshme dhe në çdo rast jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuara.</p> <p>15.2 Administratori(ët) në kryerjen e detyrave të tyre do të mbajnë përgjegjësi ndaj Shoqërisë për një veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyshme me objektin e Shoqërisë, përveç rasteve kur, në bazë të një hetimi dhe vlerësimi të informacionit përkatës, veprimi ose mosveprimi ka qenë në mirëbesim.</p> <p>15.3 Në rast shkelje të detyrimeve dhe standardeve të kujdesit që referohen në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni 15, Administratori do të ketë detyrimin për të kompensuar Shoqërinë për çdo dëm që rezulton nga shkelja. Ai/ajo do të kthejë çdo përfitim personal të marrë nga ai apo persona të lidhur gjatë shkeljes së detyrimeve të tij. Ai/Ajo do të ketë barrën e provës për të provuar përmbushjen e detyrimeve të tij dhe standardeve të kërkuara. Kur një shkelje është kryer nga më shumë se një person, të gjithë personat në fjalë do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe veçmas ndaj Shoqërisë.</p>
--	---

<p>15.4 In particular, but not exclusively, Administrators shall be obliged to compensate the Company for the damage, if they carry out contrary to the Company Law, these Articles of Association or resolutions of the General Assembly the following transactions:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. return contributions; b. pay interest or dividends; c. distribute the company's assets; d. let the company to do business when, according to its financial situation, it is foreseeable that it would be unable to pay its debts; e. grant loans 	<p>15.4 Në veçanti, por jo ekskluzivisht, Administratorët janë të detyruar të kompensojnë Shoqërinë për dëmin, nëse kryejnë në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë, këtë Statut ose vendimet e Asamblesë së Përgjithshme transaksionet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. kthejnë kontributet; b. paguan interesa ose dividendë; c. shpërndan asetet e shoqërisë; d. lejon shoqërinë të kryeje veprimtari kur, sipas gjendjes së saj financiare, është e parashikueshme që ajo nuk do të jetë në gjendje të paguajë borxhet e saj; e. japë hua
<p>15.5 Article 92, paragraph 6 of the Company Law shall also be applicable to claims under the preceding paragraphs of the present article. These claims must be submitted within 3 years of the commitment of the violation or its discovery</p>	<p>15.5 Neni 92, paragrafi 6 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohet edhe për kërkesat nga paragrafët më sipër të këtij neni. Këto pretendime duhet të paraqiten brenda 3 viteve nga kryerja e shkeljes ose zbulimi i saj</p>
<p style="text-align: center;"><u>CHAPTER IV</u></p> <p style="text-align: center;"><u>FINANCIAL MATTERS</u></p> <p style="text-align: center;">Article 16 – Auditor</p>	<p style="text-align: center;"><u>KAPITULLI IV</u></p> <p style="text-align: center;"><u>CËSHTJET FINANCIARE</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 16 – Audituesi</p>
<p>16.1 An external auditor of the Company shall be appointed by resolution of the General Assembly if necessary. The mandate of the auditor, if appointed, must be renewed annually</p> <p style="text-align: center;">Article 17 – Company Books</p>	<p>16.1 Një auditues i jashtëm i Shoqërisë do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nëse është e nevojshme. Mandati i auditorit, nëse emërohet, duhet të rinovohet çdo vit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 – Librat e Shoqërisë</p>

<p>17.1 The Company shall keep books and prepare documents recording annual accounts, financial statements, balance sheets, financial reports and any other such documents, as required by law.</p>	<p>17.1 Shoqëria do të mbajë libra dhe do të përgatisë dokumente që regjistrojnë llogaritë vjetore, pasqyrat financiare, bilancet, raportet financiare dhe çdo dokument tjetër të tillë, siç kërkohet me ligj.</p>
<p>17.2 The Company Books and the annual financial statements, balance sheets and financial reports, shall be kept in both English and Albanian; and denominated in both euro (EUR) and Albanian lek (ALL).</p>	<p>17.2 Librat e Shoqërisë dhe pasqyrat financiare vjetore, bilancet dhe raportet financiare, do të mbahen në gjuhën angleze dhe shqipe; dhe të shprehura në euro (EUR) dhe në lekë (ALL).</p>
<p style="text-align: center;">Article 18 – Financial year</p>	<p style="text-align: center;">Neni 18 – Viti Financiar</p>
<p>18.1 The financial year starts on January 1st and ends on December 31st each year, except for the first financial year which includes the period of time from the initial registration at the Commercial Register until December 31st.</p>	<p>18.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë financiar që përfshin periudhën kohore nga regjistrimi fillestar në Regjistrin Tregtar deri më 31 Dhjetor.</p>
<p style="text-align: center;"><u>CHAPTER V</u></p>	<p style="text-align: center;"><u>KAPITULLI V</u></p>
<p style="text-align: center;"><u>FINAL PROVISIONS</u></p>	<p style="text-align: center;"><u>DISPOZITA PËRFUNDIMTARE</u></p>
<p style="text-align: center;">Article 19 – Notices</p>	<p style="text-align: center;">Neni 19 – Njoftimet</p>
<p>19.1 A notice given under these Articles:</p> <p>(a) shall be in writing in English (or be accompanied by a properly prepared translation into English);</p> <p>(b) shall be sent for the attention of the person, and to the address or email address, given in this article (or such other address, email or person as the relevant party may notify to the other party); and</p> <p>(c) shall be:</p> <p>(i) delivered personally; or</p> <p>(ii) sent by email with delivery receipt; or</p>	<p>19.1 Një njoftim i dhënë sipas këtij Statuti</p> <p>(a) duhet të jetë me shkrim në anglisht (ose të shoqërohet nga një përkthim i përgatitur siç duhet në anglisht);</p> <p>(b) do të dërgohet në vëmendje të personit dhe në adresën ose adresën e e-mailit, të dhënë në këtë statut (ose një adresë tjetër, email ose person që pala përkatëse mund t'i njoftojë palës tjetër); dhe</p> <p>(c) do të:</p> <p>(i) dorëzohet personalisht; ose</p> <p>(ii) dërgohet me email me konfirmimin e marrjes në dorëzim; ose</p>

<p>(iii) sent by pre-paid first-class post or recorded delivery; or (iv) (if the notice is to be served by post outside the country from which it is sent) sent by airmail.</p>	<p>(iii) dërgohet me letër porosi me kthim përgjigje ose me konfirmimin e dorëzimit; ose (iv) (nëse njoftimi do të dërgohet me postë jashtë vendit nga i cili është dërguar) do të dërgohet me postë ajrore.</p>
<p>19.2 The addresses for service of notice are notified by email between the shareholders following the registration of the Company with the National Business Centre.</p>	<p>19.2 Adresat për dorëzimin e njoftimeve njoftohen me email ndërmjet ortakëve pas regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.</p>
<p>19.3 A notice is deemed to have been received:</p> <p>(a) if delivered personally, at the time of delivery; or (b) in the case of email, at the time of receiving the delivery receipt; or (c) in the case of pre-paid first class post or recorded delivery, 48 hours from the date of posting; or (d) in the case of airmail, five days from the date of posting; or (e) if deemed receipt under the previous paragraphs of this article is not within business hours (meaning 9.00 am to 5.30 pm Monday to Friday on a day that is not a Business Day), when business next starts in the place of receipt.</p>	<p>19.3 Një njoftim konsiderohet se është marrë:</p> <p>(a) nëse dorëzohet personalisht, në momentin e dorëzimit; ose (b) në rastin e postës elektronike, në momentin e marrjes së konfirmimit të dorëzimit; ose (c) në rastin e letër porosisë me kthim përgjigje ose konfirmimit të dorëzimit, 48 orë nga data e postimit; ose (d) në rastin e postës ajrore, pesë ditë nga data e postimit; ose (e) nëse konsiderohet se marrja sipas paragrafëve të mëparshëm të këtij neni nuk është bërë brenda orarit të punës (që do të thotë nga ora 9.00 deri në orën 17.30 nga e hëna deri të premten, në një ditë që nuk është ditë pune), kur biznesi fillon punë në momentin e marrjes.</p>
<p>19.4 To prove service, it is sufficient to prove that the notice was transmitted by email to</p>	<p>19.4 Për të vërtetuar dërgimin, mjafton të vërtetohet se njoftimi është dërguar me</p>

<p>the email address of the Shareholder or, in the case of post, that the envelope containing the notice was properly addressed and posted.</p>	<p>email në adresën e emailit të Aksionarit ose, në rastin e postës, se zarfi që përmban njoftimin është drejtuar dhe postuar siç duhet.</p>
<p>Article 20 – Liquidation of the Company</p>	<p>Neni 20 - Likuidimi i Shoqërisë</p>
<p>20.1 Upon decision on the dissolution of the Company, the General Assembly appoints one or more liquidators and determines their competences and the method of liquidation of the Company, pursuant to the relevant provisions of the Company Law.</p>	<p>20.1 Pas vendimit për prishjen e shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues dhe përcakton kompetencat e tyre dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për shoqëritë tregtare.</p>
<p>20.2 The liquidator conducts its activity in accordance with the Company Law and exercises the management and representation powers of the Company as determined in the resolution of the General Assembly.</p>	<p>20.2 Likuiduesi ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe ushtron kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të shoqërisë, të përcaktuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.</p>
<p>Article 21 – First Administrator of the Company</p>	<p>Neni 21 – Administratori i parë të Shoqërisë</p>
<p>21.1 The first Administrator of the Company appointed for a period of 5 (five) years is:</p> <p>1. Mr. Agron Disha, Albanian citizen, with ID with personal identification number: H81102064L.</p>	<p>21.1 Administratori i parë i Shoqërisë i emëruar për një mandat 5 (pesë) vjeçar do të jetë:</p> <p>1. Z. Agron Disha, shtetas shqiptar, me letërnjoftim me numër personal: H81102064L.</p>
<p>21.2 If necessary, the General Assembly shall confirm any appointment made in compliance with this article in its first meeting.</p>	<p>21.2 Nëse është e nevojshme, Asambleja e Përgjithshme do të konfirmojë çdo emërim të bërë në përputhje me këtë Statut në mbledhjen e saj të parë.</p>
<p>Article 22 – Final Provisions</p>	<p>Neni 22 – Dispozitat përfundimtare</p>
<p>22.1 The provisions of the Company Law shall apply to any matter not expressly regulated by these Articles of Association.</p>	

22.2 If any provision of these Articles is or becomes illegal, invalid or unenforceable in any respect under the laws of Albania, it shall be deemed to be severed from these Articles. In such event, the Shareholders shall use all reasonable efforts to replace it with a valid and enforceable substitute provision the effect of which is as close to its intended effect as possible and failure, and in case no agreement is reached the applicable provisions of the Company Law shall apply.

Article 23 – Entry into Force


23.1 These Articles of Association shall be prepared in four original copies in English and Albanian and shall enter into force and become mandatory upon its signature by the Shareholders. Between the Shareholders the English version shall prevail in case of any discrepancy between the two versions.

Signed in Tirana, on the 26 of April 2023

THE SHAREHOLDERS


For

Mariami Beriashvili



For

Tatia Pavliashvili



22.1 Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohen për çdo çështje që nuk rregullohet shprehimisht me këtë Statut.

22.2 Nëse ndonjë dispozitë e këtij Statuti është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë aspekt sipas ligjeve të Shqipërisë, ajo do të konsiderohet e veçuar nga ky statut. Në një rast të tillë, aksionarët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për ta zëvendësuar atë me një dispozitë të vlefshme dhe të detyrueshme, efekti i së cilës është sa më afër efektit të synuar dhe në rast se nuk arrihet marrëveshje, do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 23 – Hyrja në Fuqi


23.1 Ky Statut do të hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe dhe do të hyjë në fuqi dhe do të bëhet i detyrueshëm pas nënshkrimit të tij nga Ortakët. Versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi midis Ortakëve, në rast të ndonjë mospërputhjeje midis dy versioneve.

Nënshkruar në Tiranë, më 26 Prill, 2023

ORTAKËT

For

Mariami Beriashvili



For

Tatia Pavliashvili

